

VENDIM
Nr. 198, datë 19.6.2023

**MBI SHTYRJEN E AFATIT TË PARASHIKUAR NË KONTRATËN PËR OFRIMIN
E SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË TË OPERATORIT TË
SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH) SHA**

Ne mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike me nr. 1748/2 prot., datë 16.6.2023, “Mbi pezullimin e zbatimit të afatit të parashikuar në kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 343, datë 21.12.2022”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 257, datë 21.12.2020, ka miratuar programin e pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., ndërsa me vendimin nr. 343, datë 21.12.2022, Bordi i ERE-s ka miratuar “Kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a.”, ku në pikën 3.1.1 të saj përcaktohet se: “Zyrtari ka për detyrë, ndër të tjera dhe hartimin e një raporti vjetor, ku përcaktohen masat e marra për zbatimin e programit dhe dorëzimin e këtij raporti në ERE dhe te Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 114, datë 27.3.2023, ka miratuar emërimin e z. Ervis Hazizi, si Zyrtar i Pajtueshmërisë (ZP), të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. dhe për arsye të sqarimit të ZP-së mbi mënyrën e përgatitjes së raportit, meqenëse është raportimi i parë për z. Hazizi, në ERE, më datë 12.6.2023, u mbajt një seancë dëgjimore me praninë e z. Hazizi, përfaqësues të OSSH sh.a. dhe përfaqësues të ERE-s.

- Zyrtari i Pajtueshmërisë deklaroi se ka nisur puna për mbledhjen e të gjithë informacionit të nevojshëm për të përgatitur raportin, i cili do të depozitohet në ERE brenda 1 muaji, pra brenda datës 12.7.2023.

- Për gjithë sa u argumentua, vlerësohet të shtyhet zbatimi i afatit të parashikuar në pikën 3.1.1, të “Kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a.”, deri jo më vonë se data 12.7.2023. Kjo shtyrje afati vlen vetëm për dorëzimin e raportit vjetor të pajtueshmërisë për vitin 2022.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë afatin e parashikuar në pikën 3.1.1, të “Kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a.”, jo më vonë se data 12.7.2023.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë Zyrtarin e Pajtueshmërisë së shoqërisë OSSH sh.a. dhe Sekretariatit të Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime

materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti